



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Dr.Sc. Mazllom Kumnova

Nr.prot.: 05/1926
Datë: 16/12/2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", bazuar në nenin 12, paragrafi 1, pika 1.2 dhe nenin 22, paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", në mbledhjen e mbajtur me datë 16.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Me propozimin e Sekretares së Përgjithshme të Universitetit, **miratohet** funksionalizimi i zyreve në administratën e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", duke u bazuar në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani" me nr. 05/1994 dhe Organogramin për funksionimin r Universitetit, të datës 22.11.2019.
- II. Autorizohet Sekretarja e Përgjithshme që të ndër marrë veprimet e nevojshme për sigurimin e kushteve ligjore për funksionalizimin dhe emërimin e udhëheqësve të zyrave të administratës, në pajtim me Ligjin për Zyrarët Publik të Republikës së Kosovës, nr. 06/L-114 dhe aktet përcjellës nënligjore, Statutin e përkohshëm të Universitetit të Gjakovës si dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani".
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues duke pasur parasysh rëndësinë e organizimit të zyreve të administratës dhe emërimit të udhëheqësve të këtyre zyreve, e pa si të arsyeshëm propozimin e Sekretares së Përgjithshme të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani". Ky sistematizim synon efikasitet dhe cilësi në punë, prandaj në mbledhjen e mbajtur me datë 16.12.2020, u vendos si në dispozitiv të këtij vendim.

Ky vendim i dorëzohet:

- 1.Menaxhmentit të UGJFA-së;
- 3.Sekretarit të Përgjithshëm;
- 4.Njësave Akademike;
- 5.Arkivit të UGJFA-së.

